



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)

Gusht 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Bazuar në kalendarin trajnues gjatë muajit gusht nuk ka pasur aktivitetet trajnuese në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë si dhe për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial. Gjatë kësaj periudhe gjitha aktivitetet kanë qenë të orientuara në drejtim të përgatitjeve për trajnimet për

periudhën shtator-dhjetor 2022 si dhe në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2023.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare janë realizuar trajnimet për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo e sapo emëruar të gjeneratës së IX.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimet fillestare për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata (IX) për muajin gusht 2022

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të trajnimit teorik për 6 prokurorët e sapo emëruar janë realizuar gjithsej gjashtë (6) sesione të trajnimit teorik dhe shtatë (7) nga sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse.

Sesionet e trajnimit teorik janë realizuar nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale (4) gjithësejt dhe dy (2) nga moduli: “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese”.

Nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale janë realizuar (3) tri sesione trajnuese nga nën moduli “Menaxhimi i rasteve dhe i performancës” me ç’rast prokurorët e sapo-emëruar patën mundësinë të përfitojnë njohuri të reja rreth planifikimit si funksion kryesor i menaxhimit të rasteve nga ana e prokurorit,

SMIL-i në funksion të menaxhimit dhe udhëheqësi dhe matja e performancës së prokurorit. Nga nën moduli: “Ngritja e shkathtësive sociale” është realizuar një (1) sesion trajnues i cili kishte në fokus mbrojtjen e shëndetit dhe përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës.

Në kuadër të modulit: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese janë realizuar dy (2) sesione trajnuese nga nën moduli: Ligji për kundërvajtje. Në këto sesione u trajtuan aspekte të rëndësishme si kundërvajtja dhe vepra penale dhe kërkesa për fillimin e procedurës.

Metodologjia e trajnimit është zbatuar duke trajtuar raste praktike si dhe përmes diskutimeve interaktive.



Trajnimet fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata (IX)

Gjatë muajit gusht janë realizuar gjithsej 40 sesione, përkatësisht nga 20 sesione për dy grupet e gjyqtarëve të sapo emëruar të kësaj gjenerate.

Grupi i parë ka vazhduar me sesionet e trajnimit teorik nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, gjithsejtë 4 (katër) sesione trajnuese, të cilat kishin në fokus trajtimin e aspekteve të rëndësishme nga marrëveshja për të kryer veprat penale, dënimet plotësuese, pasojat juridike dhe rehabilitimi i të dënuarave dhe parashkrimi.

Në vijim nga ky modul edhe dhjetë (10) sesione në kuadër të cilave janë trajtuar: Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës dhe veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik dhe veprat penale të narkotikëve, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, veprat penale në kuadër si ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit [Neni 338], kapitulli XXVIII, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, kapitulli XXX, veprat penale kundër Sigurisë së trafikut publik, dhe kapitulli XXXI, Veprat Penale Kundër Administrimit të Drejtësisë dhe Administratës dhe veprat penale nga kapitulli 401 i KPRK-së.

Në kuadër të modulit: Shkathësitë personale dhe ndër personale, janë realizuar katër (4) sesione nga nën moduli “Ngritja e shkathësive sociale e gjyqtarëve” me theks te individi dhe mjedisi social, motivi, menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit dhe mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës.

Po ashtu nga nën moduli “Rregullat e komunikimit” janë realizuar dy (2) sesione me theks te rregullat, bazat dhe llojet e komunikimit.

Grupi i dytë i gjyqtarëve të sapo emëruar, ka vazhduar sesionet e trajnimit teorik nga modulet: Shkathësitë personale dhe ndërpersonale, Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese dhe E drejta civile, administrative dhe ekonomike.

Në kuadër të modulit Shkathësitë personale dhe ndërpersonale janë vazhduar sesionet e trajnimit teorik nga nën moduli “Ngritja e shkathësive sociale e gjyqtarëve”, gjithësejt katër (4) sesione nga të cilat janë shtjelluar: Individi dhe mjedisi social, motivi, Menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit dhe mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës.

Nga moduli E drejta civile, administrative dhe ekonomike janë realizuar (12) sesione, që i përkasin nën modulit “Procedura kontestimore - pjesa e parë”. Në kuadër të këtij nën moduli janë trajtuar parimet e procedurës kontestimore, shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën, përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit, palët në procedurën kontestimore, parashtrirat dhe dërgimi i shkresave, seancat, afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës, llojet e aktgjykimeve sipas LPK-së, mjetet e rregullta të goditjes, mjetet e jashtëzakonshme të goditjes si dhe rastet nga praktika gjyqësore.

Në kuadër të nën modulit “E drejta e detyrimeve” janë realizuar tre (3) sesione, nga të cilat gjyqtarët përfituan njohuri për nocionin, karakteristikat dhe klasifikimin e detyrimeve, kontratat e detyrimeve dhe shuarjen e kontratave.



Nga moduli; Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese është një (1) sesion trajnues nga nën moduli “Ndërmjetësimi” i cili kishte në fokus aspektin civil dhe rëndësinë e ndërmjetësimit në procedurat gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit për dy grupet grup është realizuar me anë të metodës së bashkëbisedimit si dhe me anë të rasteve praktike.

Nga 48 gjyqtarë të sapo emëruar, gjenerata e (XI), 3 prej tyre janë nga komuniteti serb,



Vijueshmëria në trajnim në PTF përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660